



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 25.07.2017,
e cila filloj në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi, shef i GP-së (LDK), Ismail Kasumi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Shefki Gashi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Shefqet Sylejmani (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hetem Kupina (LDK), Merita Surkishi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Misim Bajrami (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Berat Lahu (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Egzona Podvorica (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Sami Boroci (AKR), Kimet Zeqa (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, përfaqësues i subjektit politik (PD), Abetare Fazliu, përfaqësuese e subjektit politik (LB), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF) dhe Abit Kastrati.

Munguan: Vjollca Dibra - Ibrahim (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Blerand Stavileci (PDK), Shaip Shabani (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Halim Halimi, kryesues.

Kryesuesi e ftoi z. Ismail Kasumi, anëtar i LDK-së, dhe z. Misim Bajrami, anëtar i LVV-së, që ta bëjnë betimin para anëtarëve të Kuvendit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për rendin e ditës.

Agim Gashi tha se në mbledhjen e KPF-së kemi kërkuar nga Zyra ligjore, interpretimin e zbatimit të nenit 20 të Rregullores për dhënien e pronës në shfrytëzim, që ka të bëjë me pikën e pestë të rendit të ditës. Kishim dilema te neni 20, pika 4 dhe Zyra ligjore tha se do t'i bëjë shkresën ministri të përkatëse që të bëjë interpretimin e saktë, se kjo pikë e rendit të ditës a mund të bie ndesh me atë nen dhe me atë pikë, që mos të marrim një vendim dhe pastaj të na refuzohet. Po ashtu, te pika e dytë e rendit të ditës, te dhënia e pronës në periudhë afatgjate për "Hortikulturën", kur një përbajtje e këtillë nuk mund të konsiderohet rast i veçantë.

Kryesuesi ceku se është marrë një qëndrim që Zyra ligjore t'i drejtohet MAPL-së, se a kemi të drejtë të procedojmë lidhur me pikën që e tha Agimi, por, sa kam unë njohuri, nuk e ka bërë. Unë ia kam bërë një kërkesë MAPL-së, kur e kam kuptuar se Zyra ligjore nuk e ka bërë, e kam dërguar më 19.07.2017, ku kam kërkuar një sqarim, një përgjigje se kush e bën kërkesën me shkrim për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë për raste të veçanta, kur kërkuese janë ambasadat. Deri më sot nuk kam marrë prej MAPL-së ndonjë përgjigje.

Agim Gashi tha se ne si GP i LDK-së, pasi nuk kemi përgjigje, propozoj që kjo pikë të shtyhet për seancën e ardhshme, sepse nuk dëshirojmë të jemi pjesë e vendimit që pastaj mund të na i kthej prapa Ministria dhe të bëjmë shkelje adekuate ligjore.

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se kjo çështje është proceduar para dy viteve, kemi marrë vendim me kërkesë të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë, për me ia dhënë tokën në shfrytëzim afatgjatë. Vendimi ka kaluar në Kuvend dhe na është kthyer nga MAPL-ja si vendim i ligjshëm. Në qoftë se ky ligj ka qenë në fuqi kur e kemi marrë atë vendim dhe na e ka kthyer Ministria si të ligjshëm, si mundet me e kthyer si të paligjshëm kur ka precedent.

Ylli Hoxha theksoi se ky kuvend ka kompetencë mbi ndarjen e pronës, pra ky kuvend ka të drejtë, sipas një përshkrimi që e jep MAPL-ja, ta bëjë këtë vendim. Ne duhet ta ushtrojmë detyrën tonë ashtu si e përcakton Kushtetuta dhe Ligji.

Mirlinda Sopi tha se ne si GP i AKR-së, mendojmë se ky kuvend duhet t'i bëjë zgjidhje Ambasadës së Shqipërisë. Po ashtu kemi kërkuar nga Zyra ligjore të japë një interpretim të atij neni që e përcakton dhënien në shfrytëzim të asaj hapësire dhe Zyra ligjore nuk e bënë këtë.

Muhamed Selmani tha se GP i PDK-së është për dhënien e parcelës për Ambasadën e Shqipërisë, pa marrë parasysh vendin.

Feti Mehdiu theksoi se kam kërkuar, në pikën 13, të ketë një informatë që ta kemi të gjithë. Atë nuk e kemi, megjithatë mendojmë se kështu siç është ky rend dite duhet të vazhdojmë.

Remzi Pacolli dha propozim rreth një vendimi që është miratuar në Kuvendin e Komunës, rreth Komisionit për emërimin e rrugëve, për të cilin ende nuk e kanë kryer çështjen e pagesës së këtij komisioni, andaj propozoj të futet si pikë e rendit të ditës.

Shefki Gashi kërkoi që ekzekutivi të marrë vendim për kryerjen e pagesës për atë komision.

Sylejman Pireva, sa i përket emërtimit të rrugëve, tha se jemi të pakënaqur qoftë me thënien e drejtë, shkrimin e drejtë të këtyre emërtimeve, qoftë për arsyen e tjetra, andaj e konsiderojmë si punë të papërfunduar.

Kryesuesi konstatoi se më 18 (tetëmbëdhjetë) vota për, 21 (njëzet e një) vota kundër (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Egzona Podvorica, Fisnik Osmani, Halim Halimi, Hazir Borovci, Hetem Kupina, Imer Rusinovci, Ismail Kasumi, Laura Zherka, Lirie Avdiu, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Muhamet Selmani, Mustafë Krasniqi, Naime Osmani, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Shefqet Sylejmani, Vlora Dumoshi) dhe 1 (një) abstenim, (Mirlinda Sopi), Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë ndërmarrjes publike komunale "Hortikultura", tërhoqet nga reni i ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 16 (gjashtëmbëdhjetë) vota për, 13 (trembëdhjetë) vota kundër (Bardha Dida-Rogova, Berat Lahu, Genc Sherifi, Hatixhe Hoxha, Imer Rusinovci, Lirie Avdiu, Misim Bajrami, Rita Begolli, Sami Boroci, Sofije Bunjaku, Sylejman Pireva, Teuta Krasniqi, Ylli Hoxha) dhe 9 (nëntë) abstenime (Feti Mehdiu, Kimet Zeqa, Mirlinda Sopi, Muhamet Selmani, Nenad Miladinoviqi, Remzi Pacolli, Visar Arifaj, Halim Halimi, Lirak Çelaj), Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë, shtyhet për mbledhjen e radhës.

Kryesuesi konstatoi se më 26 (njëzet e gjashtë) vota për, 7 (shtatë) vota kundër (Berat Lahu, Genc Sherifi, Hatixhe Hoxha, Misim Bajrami, Teuta Krasniqi, Visar Arifaj, Ylli Hoxha) dhe 5 (pesë) abstenime (Bardha Dida-Rogova, Feti Mehdiu, Sylejman Pireva, Halim Halimi, Hetem Kupina), diskutimi për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për emërimin e rrugëve, rrugicave dhe shesheve në komunën e Prishtinës, hyn si pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 27 (njëzet e shtatë) vota për, 7 (shtatë) vota kundër, (Bardha Dida-Rogova, Berat Lahu, Genc Sherifi, Hatixhe Hoxha, Imer Rusinovci, Rita Begolli, Ylli Hoxha) dhe 3 (tri) abstenime, (Sylejman Pireva, Ajnishahe Azemi, Lirie Avdiu), u miratua ky

R E N D D I T E:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe mbledhjes urgjente të Kuvendit të Komunës;
2. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit "Vier Pfoten";
3. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (parcels 285-0);

4. Propozimvendimi për bashkimin e blloqeve F-6, F-16, F-17 në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e Re - Perëndim";
5. Propozimvendimi për ndërrimin e destinimit të bllokut C-5, në kuadër të Planit rregullues urban "Medrese - Çamëri";
6. Propozimvendimi për ndërrimin e destinimit të parcelës 494-4, në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e Re - Perëndim";
7. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (afatshkurtër);
8. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për të hyrat vetjake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës;
9. Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme;
10. Raporti për sigurinë në shkolla;
11. Njoftim lidhur me xhaminë e re në lokacionin afér Postës në Prishtinë;
12. Diskutim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe shesheve në komunën e Prishtinës;
13. Pyetje dhe përgjigje;
14. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe mbledhjes urgjente të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi tha se e keni marrë një shkresë me material, e keni prej MAPL-së një përgjigje që e kam kërkuar, ngase në mbledhjen e kaluar rrëth pikës së rendit të ditës "Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për blloqet B-17, B-18, B-19, B-20, në lagjen "Mati 1", gjatë votimit kanë qenë 14 vota për, 10 vota kundër, 7 abstenime. Unë e kam konsultuar Zyrën ligjore në atë moment dhe më është thënë nga Zyra ligjore që vendimi nuk është miratuar. Njëri nga anëtarët e Kuvendit, z. Berat Lahu na ka sugjeruar që vendimi ka kaluar, pastaj në konsultim me Zyrën ligjore unë ia kam bërë një shkresë MAPL-së për të na dhënë komente se a ka kaluar a nuk ka kaluar. Ne e kemi marrë shkresën, të cilën ju e keni në materiale, do të thotë vendimi ka kaluar dhe në bazë të shkresës së MAPL-së unë atë vendim e kam nënshkruar dhe e kam dërguar në ministrinë përkatëse, përkatësisht në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për konfirmim të ligjshmërisë. Po ju njoftoj që konfirmimi nuk ka ardhur, u bë qe një muaj a më tepër, kështu që ai vendim është marrë. Ajnishahe Azemi tha se në mbledhjen e datës 29 shtator 2016, është rikonfirmuar edhe në mbledhjen e kaluar, që të vendoset dhe të veprohet sipas vendimit që është marrë, mirëpo kryetari, më 6 qershor të këtij viti, ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit me Shoqatën Sindrom Down Kosova dhe Autizëm, me parimin "çelësat në dorë", pra edhe njëherë u bë shkelje e vendimeve të Kuvendit të Komunës.

Kimet Zeqa tha se ne Grupi i grave asambliste, kemi punuar në këtë drejtim, kjo ka nënshkruar për këtë përkrahje dhe për këtë nuk kemi çka të diskutojë më.

Kryesuesi konstatoi se më 29 (njëzet e nëntë) vota për, 4 (katër) abstenime (Misim Bajrami, Berat Lahu, Laura Zherka, Visar Arifaj), u miratuan procesverbalet e mbledhjes së tretë dhe mbledhjes urgjente të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit "Vier Pfoten".

Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, tha se aty janë të gjitha informatat, nuk mund të përgjigjë Jashtë asaj që është aty, po ashtu dokumentacionet janë mirë të plotësuara, nëse keni diçka për të pyetur, ndoshta mundemi me bërë ndryshime.

Agim Gashi u shpreh në përkrahje të këtij propozimvendimi, pasi që me këtë vendim do të krijohen kushtet që Kopshti i arinjeve të zhvillohet edhe më tutje.

Hatixhe Hoxha tha se ne e mbështesim këtë pikë.

Muhamed Selmani tha se edhe ne si GP i PDK- së e përkrahim.

Po ashtu, edhe GP i AKR-së, i AAK-së, i GIS, i PF-së, i LB-së, e përkrahën miratimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 29 (njëzet e nëntë) vota për, 3 (tri) abstenime, (Misim Bajrami, Agim Gashi, Laura Zherka), u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit "Vier Pfoten".

Pika e tretë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (parcela 285-0).

Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, propozoi që ta votojnë në mënyrën siç është propozuar nga ekzekutivi, në rast se ka probleme ligjore, atëherë kthehet nga ministria.

Agim Gashi tha se edhe këtu, sikurse në material bazë, të thuhet pika 3 a 4, si po i bie me radhë, është Propozimvendimi për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vjet, e njëjtë gjë ka qenë edhe në rastin e ndërmarrjes "Hortikultura", por nuk u mirëkuptuam.

Muhamed Selmani tha se shkresën që e ka dërguar MAPL-ja, thotë se për raste urgjente ne mund të marrim vendime për periudhë afatgjatë. Unë besoj që furnizimi me energji elektrike, ose dislokimi i trafeve, në shumë raste mundet me qenë edhe urgjente. Andaj, ne cilindo vendim që ta marrim, besoj që është i drejtë, nëse kërkohet për 15 vjet, atëherë në rregull, por edhe nëse bëhet për 99 vjet, po besoj që është në rregull.

Hatixhe Hoxha tha se në rendin e ditës e kemi të papercaktuar afatin, mirëpo brenda tekstit te propozimi, pika 5, thotë për 15 vjet. Unë mendoj që veç duhet me u harmonizuar datat, se përndryshe brenda tekstit është 15 vjet.

Ylli Hoxha tha se në përbajtje të dokumentacionit kërkohet votimi për 15 vjet, te pika 5, thotë që është afatshkurtër, kështu që nuk kemi fare dilemë, mund ta votojmë.

Kryesuesi konstatoi se më 31 (tridhjetë e një) vota për, 1 (një) votë kundër, (Shefki Gashi) dhe 2 (dy) abstenime, (Muhamet Selmani, Shefqet Sylejmani), u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (parcëla 285-0), ashtu si është në material.

Pika e katërt

Propozimvendimi për bashkimin e blloqeve F-6, F-16, F-17, në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e Re - Perëndim".

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, dha një sqarim, duke cekur se para një kohe e kemi marr një kërkesë nga qendra tregtare "Albi- Mall" për një zgjerim. Ata në ndërkohë e kanë nënshkruar një kontratë me "Indipex"-in, që është kompania më e madhe në botë e tekstit. Drejtoria e Urbanizmit iu ka drejtuar Drejtorisë së Planifikimit dhe kemi punuar së bashku për gjetjen e një zgjidhjeje që është legjitime.

Agim Gashi shprehu përkrahjen e GP të LDK-së për këtë pikë.

Gjithashtu, edhe LVV dhe PDK e përkrahën.

Visar Arifaj e bëri një pyetje lidhur me shtesën që paska me u bërë nga "Albi - Mall", pra cila është natyra e atij aneksi që do të bëhet dhe çfarë veprimtarie do të ushtrohet aty?

Genc Bashota tha se ajo kompani është "INDIPEX", ku bën pjesë firma e njohur "Zara" dhe shumë të tjera.

Kryesuesi konstatoi se më 35 (tridhjetë e pesë) vota për, 2 (dy) vota kundër, (Muhamet Nura, Shefki Gashi), 1 (një) abstenim (Halim Halimi), u miratua Vendimi për bashkimin e blloqeve F-6, F-16, F-17, në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e Re - Perëndim".

Pika e pestë

Propozimvendimi për ndërrimin e destinimit të bllokut C-5në kuadër të Planit rregullues urban "Medrese - Çamëri".

Visar Arifaj kërkoi sqarim, duke thënë se në bazë të skicës duket se janë dy pika, në të cilat janë të planifikuara institucionet parashkollore, tash a do të thotë kjo se mbetet vetëm një pikë për të dyja?

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ceku se dy janë të planifikuara me Plan rregullues, por toka nuk është e jona, është tokë e ujësjellësit "Prishtina" dhe nuk kanë mundur kurri me u realizuar si të tilla. Ne e kemi një grant që duhet me e shfrytëzuar, një shans të mirë për me e ndërtuar çerdhen dhe kemi menduar që mjafton.

Kryesuesi konstatoi se më 35 (tridhjetë e pesë) vota për, 1 (një) votë kundër, (Shefki Gashi) dhe 1 (një) abstenim, (Agim Gashi), u miratua Vendimi për ndërrimin e destinimit të bllokut C-5, në kuadër të Planit rregullues urban "Medrese - Çamëri".

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për ndërrimin e destinimit të parcelës 494-4, në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e Re - Perëndim".

GP i LDK-së dhe GP i LVV-së e përkrahën miratimin e këtij propozimi.

Muhamed Selmani kërkoi të dijë se parcela është pronë publike apo private.

Visar Arifaj pyeti se a kanë me u bërë prapë dy pika, dy QMF apo mbetet një dhe a i plotëson kërkesat e asaj pjese.

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për, 1 (një) votë kundër, (Shefki Gashi) dhe 2 (dy) abstenime (Ismail Kasumi, Merita Surkishi), u miratua Vendimi për ndërrimin e destinimit të parcelës 494-4, në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e Re - Perëndim".

Pika e shtatë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (afatshkurtër).

Kryesuesi konstatoi se më 34 (tridhjetë e katër) vota për, 1 (një) votë kundër, (Shefki Gashi) dhe 1 (një) abstenim (Laura Zherka), u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike.

Pika e tetë

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për të hyrat vetjake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës.

Besart Vllahinja, drejtori i Drejtorisë së Kulturës, tha se para se të dalin për shqyrtim publik, vlen të ceket se ky propozim ka të bëjë me krijimin edhe të një karte vjetore, një karte me parapagesë, për shfrytëzim dhe për hyrje në të gjitha institucionet e kulturës të Komunës së Prishtinës. Qëllimi i saj është rritja e të hyrave për institucionet e kulturës, pra që të kemi njëfarë planifikimi më të mirë dhe gjenerim të të hyrave për institucionet e kulturës.

Ajnishahe Azemi pyeti se a janë konsultuar këto institucione për të ardhur deri te ky propozim.

Agim Gashi tha se ne e përkrahim dërgimin në diskutim publik të kësaj rregulloreje, pasi që nuk bën që edhe më tutje institucionet e kulturës të menaxhojnë me buxhetin që e krijojnë, në kundërshtim me rregullativën ligjore përkatëse.

Hatixhe Hoxha shtoi se edhe ne jemi të mendimit që është shumë me interes me u dërguar më së pari në diskutim publik, pastaj ta ketë drejtoria atë rregullore.

Lirie Avdiu tha se ne gjithsesi e përkrahim që të shkojë në diskutim publik, mirëpo paraprakisht e kam një pyetje për pikën 2.4 të kësaj rregulloreje. Pse është e paraparë që institucionet qoftë qeveritare, qoftë lokale, të lirohen nga pagesa, kur mos lirimi nga pagesa do të kishte me i kontribuar buxhetit të teatrit.

Mirlinda Sopi shtoi se një rregullore e tillë iu ka nevojitur institacioneve kulturore, andaj edhe e përkrahim.

Bardha Dida- Rogova theksoi se kjo rregullore do të dërgohet në diskutim publik, andaj sugjerimi im është që të hiqet pagesa për anëtarësim për fëmijët e shkollave fillore, kjo për të stimuluar më shumë leximin e fëmijëve në komunën tonë.

Sylejman Pireva tha se te Biblioteka komunale, kur bëhet fjalë për të hyrat e anëtarësisë, është mirë të përmendet edhe një mundësi tjetër, të hyrat edhe nga shfrytëzimi i internetit, e që nuk figuron. Kur është fjala për lirimin nga pagesa, është mirë që këtu të përfshihen edhe ushtarët, për të cilët kudo në shtetet tjera praktikohet t'i shfrytëzojnë bibliotekat me anëtarësim falas. Nuk mendoj që është e nevojshme të lirohen nxënësit e shkollës fillore nga pagesa, kur dihet që është e shkallëzuar, sepse nuk paguan njësojë si i rrituri, si i vogli, do të thotë janë dy shkallë të pagesës.

Ylli Hoxha shprehu mendimin se duhet të ketë lirim nga pagesa për fëmijë, të cilët nuk janë kategori e njerëzve që gjenerojnë të ardhura, gjendjen edhe ashtu kështu e kemi keq me lexueshmëri te fëmijët. Në parim, arsimi duhet të ofrojë shërbime pa pagesë për publik, ku edhe biblioteka shihet si pjesë e arsimimit, andaj duhet gjithsesi për fëmijë të jetë pa pagesë.

Visar Arifaj tërroqi vëmendjen te pika 6.3, te pagesat e shërbimeve, më saktësish te teatri "Dodona". Duket që për shkak të larmisë së aktiviteteve me të cilat minden me u shfrytëzuar ato salla, nuk mundemi me dhënë çmim kaq fiks për secilin rast. Ndoshta kishte me qenë mirë, që varësisht prej natyrës së aktivitetit që kërkohet me u ushtruar aty, pagesa me qenë pak më fleksibile.

Vlora Dumoshi tha se kjo rregullore, pasi që shkon në diskutim publik, meqë përfshihen edhe OJQ-të, duhet të merren edhe mendimet e tyre. Gjithashtu, te çmimet për shfrytëzim, sidomos te teatri "Dodona" duhet të rriten, duke pasur parasysh punën e shfrytëzimit.

Feti Mehdiu theksoi se te faqja 5, pika 6, mendimi im është te punonjësit shkencorë nuk duhet me i shty në 20 euro, le të jetë 10 euro, sepse do të shkojë në diskutim. Po ashtu, le të mos figurojë shprehja "ndëshkuese", le të jetë "masat disiplinuese të përdoruesve të bibliotekës".

Kryesuesi konstatoi se më 35 (tridhjetë e pesë) vota për, 1 (një) votë kundër (Shefki Gashi) dhe 1 (një) abstenim (Hatem Kupina), u miratua Vendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren për të hyrat vetjake të institacioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme.

Muhedin Nushi, drejtor i Drejtorisë së Administratës, tha se rregullorja është e përpiluar në pëlgim të plotë me Ministrinë e Kthimit, Ministrinë e Brendshme dhe Komitetin për Komunitete dhe kemi marrë sugjerime të plota nga anëtarët e komuniteteve.

Hetem Kupina bëri vërejtje lidhur me mosplotësimin e materialit me të gjitha të dhënët që kërkohen me qenë aty, si p.sh. numri i të zhvendosurve nuk dihet, numri i atyre që duan të kthehen nuk dihet etj. Në të ardhmen duhet të punohet nëpërmes Zyrës për komunitete dhe kthim, në mënyrë që të plotësohen të gjitha këto kritere.

Hatixhe Hoxha shpresoj se Ministria e Kthimit do t'i ofrojë ato të dhëna, për këtë edhe e mbështesim.

Kjo u përkrah edhe nga GP i PDK-së, i AKR-së, i AAK-së, i PF-së dhe i PD-së.

Agim Gashi dha vërejtje për një lëshim në këtë rregullore, lidhur me edukimin, ku thuhet se, sa i përket edukimit në komunën e Prishtinës, arsimimi është mjaft i zhvilluar dhe ekzistojnë tetë institucionë parashkollore. Jo tetë, por merrni statistikat e reja dhe kontrolloni se mos keni lëshuar edhe ndonjë gabim tjetër, sepse po miratohet një dokument, i cili është mirë me qenë në rregull në aspekt statistikor. Kësaj rregullore i mungon një statistikë tjetër, për popullsinë e zhvendosur, për të cilët kjo rregullore do të vihet në shërbim.

Mustafë Neziri tha se sa i përket statistikave se sa familje janë kthyer, ato i posedojmë, por sa familje e kanë lëshuar Kosovën, komunën e Prishtinës në vitin 1999, atë nuk kemi mundur ta bëjmë, as UNHCR-ja nuk e ka një të dhënë të saktë, që ka punuar prej fillimit në këtë drejtim.

Kimet Zeqa tha se po më intereson, pasi që fondej ndahen në këtë zyrë për këto investime, në komunat tjera janë ndërtuar shtëpitë për të zhvendosurit, për të kthyerit dhe nuk janë kthyer, pra a ka kritere si do të veprohet në këtë drejtim?

Kryesuesi konstatoi se më 28 (njëzet e tetë) vota për, 2 (dy) vota kundër, (Muhamet Nura, Shefki Gashi) dhe 3 (tri) abstenime (Bardha Dida - Rogova, Ylli Hoxha, Halim Halimi), u miratua Vendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme.

Pika e dhjetë

Raporti për sigurinë në shkolla.

Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, tha se puna jonë në shkolla ka qenë në aspektin e sigurisë, në disa drejtime dhe në disa nivele, kemi punuar nga afër me shkollat, duke filluar prej drejtorëve të shkollave, mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve. Kemi bashkëpunuar me institucionet qeveritare, me Ministrinë e Arsimit, me ministritë tjera të linjës, me Policinë e Kosovës dhe kemi pasur një bashkëpunim shumë intensiv me organizatat e ndryshme joqeveritare që operojnë në Kosovë.

Rreth hapësirave shkollore, tashmë rregullorja e cila është aprovuar vitin e kaluar nga kjo asamble, edhe pse nuk ka të bëjë krejtësisht me sigurinë në shkolla, i adreson edhe çështjet e sigurisë dhe krijon mundësi për të gjithë prindërët.

Agim Gashi shprehu mendimin se fusha e sigurisë nënkupton gjithçka që ka të bëjë me jetën shkollore, prej kushteve teknike, objekteve, standardeve të brendshme, inventarit të brendshëm, pastaj anës tjetër të kulturës emergjente që ndërtohet brenda shërbimeve të kuadrove dhe faktorëve tjerë të brendshëm dhe të jashtëm, rolit të prindërve, që është përmendur në objektivat e pasqyruara. Ajo që na ndihmon neve, do të ishin të dhënët statistikore të punës të natyrës së sigurisë brenda shkollave, për të nxjerrë një konstatim se çka duhet të veprohet me prioritet për të ardhmen.

Hatixhe Hoxha theksoi se siguria në shkolla në nivel të vendi, nuk është e mirë. Përveç tjerash, në shkolla duhet të shtohet numri i psikologëve, që të dihet arsyaja se pse vjen deri te kjo dhunë, ose pse fëmijët ushtrojnë dhunë me njëri-tjetrin, por edhe të shtohet numri i kamerave në shkolla.

Muhamed Selmani, sa i përket dhunës si fenomen dhe dënimit si masë disiplinore, tha se më intereson ta dijë a kemi ndonjë statistikë, pra numrin e masave që janë shqiptuar, pa marrë parasysh nivelin. Po ashtu, a kemi ndonjë statistikë, për numrin e incidenteve që kanë ndodhur në shkolla gjatë kësaj periudhe, dhe si janë klasifikuar këto incidente, duke shkuar prej atyre më të voglave deri te ato më të mëdha?

Mirlida Sopi theksoi se e kemi analizuar dhe jemi të vetëdijshëm që Plani i veprimit 2015-2018, ka arritur një siguri pak më të lartë në shkolla se në vitet e kaluara. Kishte me qenë mirë që Drejtoria me i pasur parasysh shkollat në të cilat ka pasur më tepër incidente, me e shtuar sigurinë përmes kamerave.

Feti Mehdiu shtoi se sa u përket kujdestarëve të klasave, ata fare nuk paguhen, prandaj është mirë t'u sigurohet stimulimi dhe t'u kërkohet përgjegjësia, e si ndihmë të sigurohen kamerat. **Visar Arifaj** tha se nuk po përfillet rëndësia e ngacmimeve kibernetike, pra mënyra se qysh duam me reaguar ndaj këtij lloj ngacmimi, që në fakt është një prej formave dominuese të dhunës psikologjike që ushtrohet nëpër shkolla. Mendoj se nuk mjaftojnë kamerat, nuk mjaftojnë kujdestarët për këtë punë, por na duhen mekanizma të veçantë, në të cilat mundet me u raportuar dhe me u marrë masat e duhura.

Ajnishahe Azemi tha se kur është në pyetje roli i kujdestarit tek klasat për siguri, është mirë që ndoshta të krijohen mundësi për mbajtjen e orës të kujdestarisë. Pastaj edhe për çështjen e pagesës, është mirë që të bëhet, dhe sigurisht roli i kujdestarit në siguri dhe në çështjet tjera do të ishte shumë më i madh.

Hetem Kupina ceku se në Komunën e Prishtinës funksionojnë katër këshilla lokalë për siguri publike, të cilët janë të obliguara t'i sjellin të gjitha të dhënat mbi shkaktarët që e cenojnë sigurinë në shkolla. Pra, bazuar në ato të dhëna, përpilohet strategjia dhe nxirret plani i veprimit, pastaj dalin me një raport që në komunën e Prishtinës kanë ndodhur këto gjëra. Prandaj, është dashur të ceket në raport se në ato shkolla kemi mbajtur trajnime për edukimin e nxënësve për këtë lëmë.

Ylli Hoxha, sa i përket Planit të veprimit, ku flitet për infrastrukturën fizike, tha se ka qenë shumë mirë vendosja e "policëve të shtrirë" para shkollave. Është shumë e rëndësishme që secila shkollë ta ketë ndriçimin për pjesën dimërore të vitit. Një prej elementeve që do të duhej t'i shtohej Planit të veprimit, është fushata e vetëdijesimit për dëmin që dhuna ua shkakton fëmijëve.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Raporti për sigurinë në shkolla.

Pika e njëmbëdhjetë

Diskutim për projektin e xhamisë së re në Prishtinë.

Kryesuesi ceku se lidhur me projektin e xhamisë do të njoftohem i sot, por kurrfarë vendimi ne sot nuk mund të marrim. Më 23 shkurt të vitit 2012, Kuvendi e ka marrë një vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë qendrore në Prishtinë. Projektin e ka dërguar Bashkësia Islamë e Kosovës, konkursi ka qenë, shpresojmë që Urbanizmi ka bashkëpunuar

Faqe 10 nga 17

me ta, është çështje e ekspertëve me e zgjedhur projektin. Sa i përket Kuvendit, unë mendoj që kjo është çështje e kryer.

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se në vitin 2012 është dhënë lokacioni për xhami, afër Postës, është marrë vendimi atëherë në Kuvendin e Komunës, përkundër faktit që unë mendoj se ka lokacione më të mira, por kjo për mua është çështje e përfunduar. E kemi diskutuar me Bashkësinë Islame të Kosovës, nuk ka kurrfarë arsyë këta me lëvizë, unë po mendoj që ka hapësira më të mëdha, megjithatë kanë insistuar që ky me qenë lokacioni. Kjo xhami do të financohet nga Bashkësia Islame Turke.

Resul Rexhepi, përfaqësues i Bashkësisë Islame të Kosovës, tha se Prishtinës si kryeqytet i mungon një xhami qendrore, prandaj xhamia për të cilën ne kemi menduar, ka qenë tash momenti i fundit që edhe ajo të ndërtohet. Me vendosjen e një gur-themeli për xhaminë qendrore dhe këtë e kemi pas realizuar në mënyrën më të mirë të mundshme, u kuptua se për këtë na ndihmuani dhe na e bënë të mundshme pikërisht liderët tanë politikë, sepse ata të gjithë morën pjesë në vendosjen e gur-themelit. Xhamia tash për tash do të jetë më e madhja në Ballkan, dhe unë shumë shpresoj në përkrahjen tuaj.

Esat Ramadani, arkitekt, në mënyrë elektronike bëri prezantimin e projektit të xhamisë qendrore para asamblistëve.

Agim Gashi tha se objekti duhet t'i përshtatet lokacionit, e jo lokacioni objektit, e kur thuhet nuk mund të zvogëlohet për me e përfillë vijën urbanistike, nuk po mundem me kuptuar.

Shefki Gashi tha se ne si LDK, pa hezitim e kemi votuar, por edhe të gjitha subjektet politike që kanë qenë në përbërjen e Kuvendit të Komunës. Ne e kemi dhënë parcelën, por duhet të bëhet ndryshimi i planit rregullues apo urban në atë pjesë, me të cilën kurdo që e sjellë ekzekutivi, ne kemi me e aprovuar.

Ai propozoi që të bëhen përpjekje për ta financuar populli i Kosovës ndërtimin e kësaj xhamie. **Ylli Hoxha** tha se sa i përket, orientimit të objektit, mendoj se nuk përkon me vend-lokacionin. Vend-lokacioni në vitin 2012 është ndarë gabimisht, sepse orientimi e deformat paksa pjesën arkitektonike të rrugës. Madhësia e parcelës nuk korrespondon me madhësinë e objektit, andaj konsideroj se për këtë lloj objekti, është dashur të ndahet parcelë shumë më e madhe.

Muhamed Selmani kërkoi sqarim se cilat kanë qenë kriteret e përzgjedhjes së projektit, apo arkitekturës së xhamisë. Gjithashtu ai kërkoi të dijë se ku janë burimet e financimit të kësaj xhamie dhe kah do të vijnë të gjitha këto financime. Ai u shpreh se vërejtjen e vetme që e kam është se arkitektura e xhamisë është neoklasike osmane, andaj kërkoj të di se pse është zgjedhur kjo arkitekturë klasike osmane dhe pse duhet të ndërtohet një objekt klasik osman në një vend modern evropian. Më mirë është të bazohemi në arkitekturë klasike të kullave shqiptare dhe të bëhen xhamia.

Mirlinda Sopi tha se vendimi është marrë, GP i AKR-së është që të ndërtohet kjo xhami sa më parë.

Rita Begolli tha se edhe ne si GP i AAK-së e përkrahim pa hezitim këtë kérkesë.

Feti Mehdiu theksoi se duhet vetëm të pajiset me leje për ndërtim, të gjitha të tjerat janë kryer. Kombi është ky që është, feja është kjo që është, shteti është ky që është, t'i mbajmë kështu siç janë dhe të vazhdojmë punët.

Visar Arifaj tha si e tillë kjo xhami ndoshta ka me qenë më e madhja në Ballkan, jo vetëm për besimtarët dhe për ata që kanë me e praktikuar aty besimin, por edhe për të gjithë banorët e

Prishtinës. Ky objekt nuk është vetëm për nevojat e sotme, është për nevojat e gjeneratave që do të vijnë, ka me mbi jetuar dekada e shekuj.

Nenad Milladinoviqi tha se si besimtar i besimit ortodoks, e përkrah dhe e mbështes ndërtimin e objektit të xhamisë.

Sylejman Pireva e sheh si gabim, që një objekt kaq grandioz, të futet në një hapësirë me kaq sipërfaqe, ky lokacion nuk është për këtë lloj xhamie. Ai u shpreh kundër ndërtimit të kësaj xhamie në këtë lokacion dhe nuk e sheh këtë si çështje të përfunduar.

Shaip Hajrizi ceku se një objekt i tillë ka qenë i nevojshëm dhe është i nevojshëm pikërisht aty ku e ka vendin, sepse lokacion me një sipërfaqe të tillë nuk kemi mundur ta gjejmë në qendër të qytetit. Pra, kjo është një çështje që është e kaluar dhe është vendosur, nuk mund të kthehem prapa.

Kimet Zeqa tha se më pëlqeu që e kishit projektuar edhe parkingun dhe propozojmë që në ditën e xhumasë me qenë parkingu pa pagesë për xhematin.

Lirak Çelaj shprehu mendimin se çështjet e tillë që kanë të bëjnë me religionin në këtë kontekst global, jo vetëm vendor, për të cilin jemi të përfshirë edhe ne, për mua paraqesin shqetësim. Hapësirë tjetër në qendër nuk ka që do t'i përshtatej një xhamie të tillë. Rreth çështjes së parkingut dhe dyqaneve, unë mendoj se do duhej të ishte i domosdoshëm ky ndërtim.

Mustafë Krasniqi tha se konkursi ose procedurat tjera për hartimin e fillimit të projektit të kësaj xhamie, janë bërë mbi bazat e caktimit të lokacionit, do të thotë lokacioni është ditur, dimensionet, përmasat e lokacionit janë ditur, pastaj kanë filluar procedurat tjera për me u përzgjedhur projekti.

Fisnik Osmani pyeti se sa mund të zgjatë kjo pjesa e vakumit të zgjidhjes teknike ose të procedurave, në mënyrë që ne të fillojmë të procedojmë me ndërtimin e xhamisë.

Ajnishahe Azemi shprehu dëshirën që sa më shpejt të ndërtohet xhamia në lokacionin e përcaktuar në vitin 2012, dhe të jetë me përmasa të tillë, të cilat do t'i plotësonin dhe do t'u mundësonin besimtarëve myslimanë t'i kryejnë adhurimet ndaj Zotit.

Kryesuesi falënderoi anëtarët e Kuvendit, si dhe përfaqësuesit e Bashkësisë Islame të Kosovës për informatat e dhëna rreth ndërtimit të projektit të xhamisë.

Pika e dytëdhjetë

Diskutimi për kompensimin e anëtarëve të Kuvendit, të cilët kanë qenë në Komision për emërtimin e rrugëve dhe shesheve të Prishtinës.

Kryesuesi tha se çështja e kompensimit të anëtarëve të komisionit të jetë si rekomandim i këtij Kuvendi, që ekzekutivi seriozisht të merret me çështjen e kompensimit të anëtarëve të komisionit për caktimin e emërtimit të rrugëve dhe shesheve të Prishtinës.

Nenad Miladinoviqi bëri vërejtje në aspektin drejtshkrimor të shkrimit të emrave të rrugëve njëherësh kërkoi nga komisioni dhe organet kompetente të Komunës, që t'i përmirësojnë gabimet rreth emërtimit të rrugëve.

Muhedin Nushi, drejtori i Drejtorisë së Administratës, lidhur me drejtshkrimin e rrugëve në gjuhën serbe, tha se janë në pyetje tri ose katër rrugë, por, sido çoftë, vendimi i Kuvendit është për ato rrugë ashtu siç është e shkruar.

Nëse është gabimi në shtyp, është i lehtë korrigimi, por nëse duhet me u ndryshuar, atëherë duhet vendimi i Kuvendit, pra ato rrugë duhet me ardhur me korrigim, sepse duhet patjetër me kaluar përmes Kuvendit të Komunës.

Sami Boroci tha se jam kundër kompensimit të këtij komisioni në këtë fazë, sepse unë konsideroj se puna ende nuk është kryer edhe pse ka kaluar në Kuvend.

Ai bëri të ditur se shumë shpesh në kutitë postare të asamblistëve arrijnë ankesa lidhur me emërtimin e rrugëve.

Pika e trembëdhjetë

Pyetje dhe përgjigje

Kimet Zeqa, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Në rrugën "Luan Haradinaj", kontejnerët që janë vendosur aty d.m.th. kontejnerët nentokësorë, si duket janë stërbushur dhe vjen erë e rëndë, sa që nuk mund të hapësh as dritaret. Kjo gjendje është incizuar edhe nga televizioni. Kërkesa e qytetarëve është që të ndërmerren masa për pastrimin e këtyre kontejnerëve.

Remzi Pacolli kerkoi të bëjë sqarim lidhur me gabimet teknike që mund të hasen në drejtshkrim të emërtimit të rrugëve. Për këto lëshime kompetente është Zyra në drejtorinë përkatëse në objektin e ri të Komunës, ku mund të paraqiten dhe të përmirësohen pa asnjë problem. Sa i përket ndërrimit të emrave, komisioni e ka përfunduar punën dhe tash nuk është më. Nëse duhet krijuar një komision tjetër sipas Rregullores që ne kemi punuar, është diçka tjetër. Për ndryshimin e emrave në rrugë të caktuara që disa banorëve nuk ju pëlqejnë, është procedura sipas Rregullores së emërimit të rrugëve dhe sheshevë publike, është Rregullorja e cila secilit qytetar ia mundëson, në çdo kohë, nuk ka afat të caktuar, që në një rrugë ku nuk iu pëlqen emri i saj, ata duhet ta marrin iniciativën prej asaj rruge, që ta marrë gjatësinë e rrugës në Plan rregullues sa është ajo, t'i mbledhë nënshkrimet mbi 50% të banorëve që banojnë në atë rrugë dhe pastaj t'ia dorëzon zyrës në Komunë, ku ata edhe e bëjnë ndryshimin pa ardhur në Kuvend.

Por, nuk duhet me qenë propozues vetëm një qytetar edhe me e ndërruar emrin e asaj rruge pa qenë nënshkrimet e mbi 50% të qytetarëve që banojnë në atë rrugë.

Rregullorja momentalisht nuk parasheh propozime të reja, përveç 400 emrave që janë në listën rezervë për emërimin e sheshevë të reja që do të krijojen apo rrugëve që do të krijojen në vazhdim.

Kur të ndryshohet një emër rruge, mundet me u bartë një emër prej asaj liste që është rezervë dhe përzgjidhet prej atyre njerëzve që e kanë bërë peticionin. Kjo është procedura që mundemi me bërë në çdo kohë ndryshimin e emrit të rrugës.

Kryesuesi tha se në Shërbimin e Kuvendit kanë ardhur disa kërkesa për emërtim, por ne prej mbledhjeve të ardhshme ose do ta formojmë një komision tjetër dhe do t'i marrë edhe ato kërkesa dhe kërkasat tjera dhe procedojmë, por sigurisht me to do të merret struktura e re e Kuvendit të Komunës, sepse tanë jemi në përfundim të këtij mandati.

Faqe 13 nga 17

Sylejman Pireva, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për Zyrën ligjore.

Në të gjitha ndërmarrjet publike zgjedhja e drejtorit dhe emërimi i drejtorit bëhet me mandat.

Unë kërkoj sqarim dhe përgjigje edhe me shkrim për mbledhjen e ardhshme, se a kemi ndonjë institucion publik ku është bërë një precedent, ku drejtori nuk është zgjedhur, nuk është shpallur konkursi dhe ai vazhdon të punojë pa mandat.

Shaip Hajrizi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Meqenëse nuk qenka drejtori i Shërbimeve Publike, e kam bërë disa herë një pyetje dhe kërkesë dhe nuk mundem me kuptuar se si është e mundur që mos me pasur një kujdes në atë që kemi kërkuar.

Është fjalë për trotuar, unë nuk mundem me kuptuar pse trotuari nëse është tri metra dhe tri metra i jepen lokalit në shfrytëzim dhe asnje centimetër nuk ka mundësi këmbësori me shkuar nëpër trotuar, por duhet me dal në rrugë.

Kjo ndodh në shumë pjesë të qytetit, por dy-tri vende janë në rrugën te Kinema ABC, në drejtim të policisë. Për mua është e pakuptueshme se si Komuna mundet me dhënë komplet trotuarin në shfrytëzim për lokale.

E dyta, Parku mbi ish-Tjegulloren, kam shumë kërkesa prej qytetarëve se pse nuk ka filluar sivjet me u rregulluar.

Dhe në fund një pyetje për drejtorin Hysen Durmishi. Tash e tri vjet më ka premtuar për një rrugë edhe kryetari, edhe drejtori, edhe kemi bërë shumë biseda, është kryera projekti me sa e di unë, edhe pas tri viteve, mos të them e vetmja rrugë, mos të them se ka edhe rrugë të tjera, normal që ka, por unë e di që në atë rajon janë bërë ndoshta do rrugë edhe më larg shumë se ajo. A ka mundësi me u kryer sivjet ajo rrugë? Është fjalë për një rrugë në fshati Keqekollë.

Sami Boroci, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

Kam marrë disa kërkesa prej banorëve të lagjes "Prishtina e Re" ose, më konkretisht ajo lagjja në fillim të Hajvalisë, aty ndër Fshatin Ndërkombëtar, po besoj se je në ngjarje, edhe ti ke qenë aty në atë pjesë ku ka me u shtruar ajo rrugë, nëse veç ka me u shtruar, është në gjendje shumë të mjerueshme. A ka ndonjë përgjigje konkrete se kur ka me u shtruar kjo rrugë, sepse, nëse nuk gaboj, është premtuar se ka me u shtruar sivjet.

Nenad Miladinoviqi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

Pasi që drejtori i Infrastrukturës është këtu prezent dhe është i njoftuar me problemin e kanalizimit në Bërnicë të Poshtme, desha ta lus edhe njëherë që të kyçet dhe të

ndërmerr masa për zgjidhjen e atij problemi, pasi që ata banorë janë në hall të madh, sepse kanalizimi u hyn nëpër oborre të shtëpive.

Visar Arifaj, pyetje për ekzekutivin.

Pasi vetëm e patëm diskutimin për xhami, kisha dashur një përgjigje prej ekzekutivit lidhur me Xhaminë e Çarshisë. Pse ka mbetur në këtë gjendje që është dhe ku janë bllokadat, pse nuk po mundet me u ndërmarr diçka, së paku me i bllokuar qytetarët për mos me hy aty me shkatërruar, derisa të zgjidhen problemet që i ka?

Bardha Dida - Rogova, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

A ka plan për rregullimin e rrugëve që janë në Lagjen e Muhamxhirëve, aty është duke u ndërtuar shumë dhe rrugët janë shumë të shkatërruara. Kur mund të riparohen ato rrugë?

Edhe rruga që është në pjesën e sipërme të parkut, që e lidhë lagjen "Velania" me qytetin, a ka plan për rregullimin e saj?

Hysen Durmishi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se rruga në lagjen "Çelaj" është e projektuar, e kemi tenderuar rrugën në lagjen "Kurtaj", ku janë duke u zhvilluar punimet.

Arsyeja e vetme pse nuk është tenderuar rruga e lagjes "Çelaj" është buxheti. Kemi shpresuar si ekzekutiv që do t'i marrim mjetet të cilat na i ka borxh Ministria, Qeveria e Kosovës në fakt, që kanë premtuar se në këtë vit kanë me filluar me na i dhënë, e ato do të parashiheshin për investime kapitale.

Problemi kryesor është çështja e buxhetit. Do ta shohim mundësinë se eventualisht a mund ta tenderojmë sivjet, por nuk mundem me premtuar se do të kryhet gjatë këtij viti. Në fshatin Hajvali, veç janë në procedurë të vlerësimit dhe besoj se brenda dy javëve veç fillojnë punimet.

Të gjitha ato rrugë janë të parapara në kuadër të dy kontratave që janë për Veternikun dhe Hajvalinë.

Për çështjen e kanalizimit në Bërnicë, edhe z. Nenadi e din që i di krejt problemet që janë aty, ne disa herë kemi intervenuar në atë kanalizim. Është edhe çështje e banorëve të cilët janë të papërgjegjshëm. Ne herën e fundit kur kemi intervenuar, kemi gjetur gjithçka në atë kanalizim, sikurse me dashur me e myllur me qëllim, edhe armatura kemi gjetur brenda gypave të kanalizimit etj.

Si zgjidhje e përhershme e këtij problemi është kur të zgjidhet problemi që ne e kemi të projektuar, por që kushton shumë shtrenjtë dhe ne si Komunë nuk po mundemi me kryer komplet si zonë kanalizimin e Bërnicës së Poshtme, Bërnicës së Epërme të asaj pjese atje, d.m.th rregullimin e kolektorit atje.

Sa i përket problemit të cilin e ngriti Bardha, janë duke u zhvilluar ndërtime aty dhe është shumë problem me investuar në infrastrukturë në vendet ku është ndërtimi, sepse po kalojnë me pesha shumë të rënda, nuk po funksionon njëfarë sistemi i policisë

dhe inspektoriatit për me i dënuar kompanitë për kamionët me mbipesha, për shkak se nuk kanë as pajisje për matjen e tyre.

Fatkeqësish, gjendja është ashtu siç është dhe rrugët po dëmtohen shumë shpejt. Në lagjen "Mati 1" ne kemi intervenuar para tri viteve, menjëherë në fillim të qeverisjes tonë, dhe një pjesë e rrugëve janë dëmtuar pikërisht për shkak se atje kalojnë kamionë me peshë shumë të rëndë, dhe është e pamundur për me i përballuar atij fluksi të ndërtimit. Megjithatë, për të gjitha pyetjet që u bënë, unë për seancën e radhës ua kthej me shkrim.

Mirlinda Sopi, kërkesë për Zyrën ligjore.

Unë vetëm po dua me e përsëritur kërkesën e njëjtë të Komitetit për Politikë dhe Financa. Zyrës ligjore i kemi kërkuar me interpretuar çështjen e votimit për zgjedhjen e aksionarit në Kompaninë "Pastrimi".

Unë kërkoj të ma kthejnë përgjigjen me shkrim, të interpretuar në aspektin ligjor se si ka shkuar mënyra e votimit. Nuk është tendenca ime me qenë pjesë e asaj kompanie, tendenca është për ta krijuar një kulturë të proceseve si duhet të bëhet votimi i aksionarëve edhe kur nuk janë numrat, duhet me qenë komform ligjit, e jo veç kur janë numrat me i quar anëtarët e partive.

Prandaj, ju lutem shumë, edhe njëherë le të evidentohet në procesverbal. Zyra ligjore asnjë kërkesë që e japim nuk e kryen. Për këtë pres përgjigje me shkrim.

Pika e katërmëdhjetë

Të ndryshme

Remzi Pacolli kërkoi një sqarim që po diskutohet rreth gabimeve teknike që munden me qenë në drejtshkrim. Për këto lëshime kompetente është Zyra në drejtorinë përkatëse në objektin e ri të Komunës, ku i paraqesin dhe përmirësohen ato pa asnje problem.

Ndërsa te ndërrimi i emrave, Komisioni e ka përfunduar punën dhe tash nuk është më, ai e ka përfunduar procesin e punës. Nëse duhet me e krijuar një Komision tjetër sipas Rregullores që ne kemi punuar, është diçka tjetër, mirëpo ndryshimin e emrave në rrugë të caktuara që disa banorëve nuk u pëlqejnë, është procedura sipas Rregullores së emërtimit të rrugëve dhe shesheve publike, është Rregullorja e cila çdo qytetarit ia mundëson, në çdo kohë, nuk ka afat të caktuar, që në një rrugë ku nuk iu pëlqen një emër ata duhet ta merr dikush iniciativën prej asaj rruge, që ta merr gjatësinë e rrugës në Plan rregullues se sa është, ti mbledhë nënshkrimet e mbi 50% të banorëve që banojnë në atë rrugë dhe pastaj t'ia dorëzojnë zyrës në Komunë, ku ata edhe e bëjnë ndryshimin pa ardhur në Kuvend.

Por, nuk duhet me qenë propozues vetëm një qytetar dhe me e ndërruar emrin e asaj rruge pa qenë nënshkrimet e mbi 50% të qytetarëve që banojnë në atë rrugë.

Kjo është procedura që nuk përfundon, se në çdo kohë është e mundshme ky ndryshim i emrit.

Rregullorja nuk parashev propozime të reja, përvèç 400 emrave që janë në listën rezervë për emërimin e shesheve të reja që do të krijohen apo rrugëve që do të krijohen në vazhdim. Kur të ndryshohet një emër, mundet me u bartur një emër prej asaj liste që është

rezervë, përzgjidhet prej atyre njerëzve që e kanë bërë peticionin. Pra, kjo është procedura që mundemi me bërë në çdo kohë ndryshimin e emrit të rrugës.

Kryesuesi tha se në Shërbimin e Kuvendit kanë ardhur disa kërkesa për emërtimin e rrugëve, por në njëren nga mbledhjet e ardhshme, ose do ta formojmë një Komision tjetër dhe do t'i marrë ato kërkesa bashkë me kërkesat tjera edhe procedojmë, por sigurisht me to do të merret struktura e re e Kuvendit, sepse tash veç jemi në përfundim të mandatit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

Procesmbajtësja
Luljeta Selimi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur.i dip.



Faqe 17 nga 17